



Partitë politike të serbeve të Kosovës në sistemin politik kosovar:

Prill
2021

Nga pluralizmi
në monizëm



Karakteristikat e shoqërisë së hapur në komunitetin serb të Kosovës

A janë dhe sa të hapura mediat serbe në Kosovë

Qëndrimet e Serbëve të Kosovës mbi institucionet e sigurisë

Serbët e Kosovës në procesin e dialogut

Organizatat e shoqërisë civile në komunitetin serb të Kosovës – Në mes të perceptimit dhe prezantimit

Qasshmëria e institucioneve për qytetarët në Kosovë

Analiza e gjendjes ekonomike të komunitetit serb në Kosovë

Partitë politike të serbëve të Kosovës në sistemin politik të Kosovës: Nga pluralizmi deri te monizmi

Të drejtat e komuniteteve në Kosovë

Titulli i hulumtimit: Partitë politike të serbeve të Kosovës në sistemin politik kosovar:
Nga pluralizmi në monizëm

Botues: KFOS

Për botuesin: Iniciativa e re shoqërore (Nova društvena inicijativa) dhe Qendra Mediale (Medija centar)

Autori: Jovana Radosavleviq, Budimir Niçiq

Gjuha origjinale në të cilën është punuar analiza është gjuha Serbe

Përkthimi në gjuhën shqipe: Xhenana Azizi

Dizajni: tedel

Shtypshkronja (Tirazhi): tedel (100)

Ky botim u realizua në kuadër të projektit OPEN të implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në bashkëpunim me organizatat Iniciativa e re shoqërore dhe Qendra Mediale. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS.

Viti i botimit: 2021

PËRMBAJTJA

01.

HYRJE 6

Përmbledhja ekzekutive 6

02.

**QËLLIMI DHE
METODOLOGJIA E
HULUMTIMIT** 7

Metodologjia dhe modeli i
hulumtimit sasior: 7

Hulumtimi cilësor: 8

Metodologjia dhe dizajni i
kërkimit cilësor: 9

03.

**PARTITË POLITIKE
SERBE TË KOSOVËS,
NGA PLURALIZMI
TE MONIZMI** 9

Hyrje 9

04.

**NDIKIMET NË
ZHVILLIMIN E
SISTEMIT PARTIAK
SERB TË KOSOVËS** 10

Dimensioni i përkohësisë
përkatësisht kohorë i ndikimit
në zhvillimin e partive
politike serbe në Kosovë 10

Dimensioni gjeografik i
zhvillimit të partive politike
serbe në Kosovë 11

Roli i Beogradit dhe ndikimi
i tij në zhvillimin e partive
politike në Kosovë 12

Dimensioni ideologjiko-
politik i zhvillimit të partive
politike serbe në Kosovë 13

Partokracia dhe
marrëdhënia klienteliste
midis qytetarëve dhe
partive politike 14

Sistemi partiak dhe
zgjedhor 14

05.

**CILËT JANË
AKTERËT E
RËNDËSISHËM DHE
ROLI I TYRE** 16

06.

**REZULTATET E
HULUMTIMIT DHE
KONTEKSTUALIZIMI
I TYRE** 19

07.

REKOMANDIME 33

Hyrje

Përmbledhja ekzekutive

Partitë politike dhe politika serbëve të Kosovës u zhvilluan në një mjedis kompleks socio-politik. Të nxënë midis një çekani dhe kudhre, varësisë politiko-ekonomike dhe besnikërisë së kërkuar nga Beogradi, si dhe presionit për të marrë pjesë në jetën politike të Kosovës, serbët e Kosovës, përkundër përpjekjeve të shumta, ishin përgjithësisht të kufizuar në artikulumin e politikave të tyre. Të ballafaquar me një deficit demografik, emigracion, mungesë të potencialit njerëzor, si dhe humbje të elitës intelektuale dhe akademike, ata ishin kryesisht (përveç në momente të rralla) të dënuar të jenë një instrument politik, por jo një aktor i rëndësishëm politik. Në një mjedis të tillë, zhvillimi i partive politike dhe sistemi i partive në mesin e serbëve të Kosovës ishte kaotik, ad hoc dhe i kushtëzuar nga prirjet më të gjera politike dhe shoqërore, si në drejtim të zgjidhjes së statusit të Kosovës ashtu edhe në ndryshimet politike në Beograd.

Kjo analizë adreson çështjen e pluralizmit politik në sistemin politik dhe partiak të serbëve të Kosovës nga viti 1999 deri më tani dhe perceptimet e qytetarëve për partitë politike. Përmes analizës së gjashtë dimensioneve të ndikimit në zhvillimin e sistemit partiak, përkatesisht: dimensionit të përkohësisë (kohorë); dimensionit gjeografik; dimensionit ideologjiko-politik; partokracisë dhe klientelizmit; rolit dhe ndikimit të Beogradit tek serbët e Kosovës; sistemit partiak dhe zgjedhor, autorët japin një pasqyrë në trajektoret e zhvillimit historik të partive politike, dhe arsyet e mungesës së pluralizmit politik. Autorët konstatojnë se pellgu kritik që përcaktoi

trajektoren e zhvillimit të sistemit politik dhe partiak të serbëve të Kosovës ishte nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit në vitin 2013, dhe se Beogradi historikisht ka luajtur një rol kryesor në funksionimin e partive politike dhe përfaqësuesve politik të serbëve të Kosovës dhe nevoja për të ruajtur unitetin politik të serbëve të Kosovës në procesin e dialogut me të gjitha mjetet më pas shkaktoi shfaqjen e monizmit politik dhe partiak dhe mungesën e pluralizmit. Partitë politike serbe të Kosovës janë më shumë një instrument sesa një aktor në ngjarjet politike. Gjithashtu, mungesa e pluralizmit politik rezultoi në një shkallë të rritur të partokracisë, dhe prezente është një marrëdhënie klienteliste midis partive dhe qytetarëve, sepse në mungesë të institucioneve të ndërtuara mjaftueshëm, partia bëhet një adresë përparimi në hierarkinë shoqërore.

Autorët konstatuan një nivel të lartë të largimit nga bota e politikës midis serbëve të Kosovës, e pasqyruar në mungesë besimi në aktivizmin politik, si dhe mungesë të hapjes dhe pranisë së frikës për të shprehur opinionet personale. Mungesa e besimit të partitë politike dhe përfaqësuesit e tyre është gjithashtu e dukshme në hulumtimin e kryer të opinionit publik. Qytetarët dyshojnë në qëllimet e përfaqësuesve politikë, gjë që reflektohet në besimin e tyre se politikanët kujdesen më shumë për interesat e tyre personale dhe nuk i kuptojnë nevojat e qytetarëve. Autorët konkludojnë se ka nevojë që të punohet më gjatë me qytetarët, por edhe me ndryshimin e mjedisit institucional në mënyrë që të përmirësohet funksionimi i sistemit politik-partiak, mirëpo sukcesi i ndërhyrjes do të varet nga mjedisi politik-social dhe konteksti.

2. Qëllimi dhe metodologjia e hulumtimit

Qëllimi i përgjithshëm i hulumtimi është të ofrojmë të dhëna të matshme mbi demokracinë dhe pluralizmin e partive politike serbe në Kosovës. Qëllimi specifik i hulumtimit është të përcaktojë arsyet e mungesës së pluralizmit politik në jetën politike të serbëve të Kosovës dhe hapjen e qytetarëve dhe partive politike për pjesëmarrje në institucionet politike të Kosovës. Pyetja kryesore e hulumtimit që kontribuon në arritjen e qëllimit të përgjithshëm dhe specifik është: cilat janë arsyet e mungesës së pluralizmit politik brenda komunitetit serb në Kosovë.

Periudha: Hulumtimi u realizua në periudhën nga 01 - 20 tetor 2020

Metoda e mbledhjes së të dhënave: Ballë për ballë (F2F), studim në terren (D2D)

Metoda e kontrollit të punës së intervistuesve: Google maps (GPS) live location sharing

Lloji: Letër dhe laps

Instrumenti i hulumtimit: Pyetësori i anketës i përbërë nga 65 pyetje

Mostra: mbi 18 vjeç

Lloji i mostrës: Qëllimi, kuota

Kriteri i përcaktimit të kuotave: Madhësia

e komunës sipas numrit të popullsisë me kuota të paracaktuara për komunat dhe vendbanimet në jug (287/300) dhe në veri të lumit Ibër (295/300)

Madhësia e mostrës: 582 të anketuar me vendbanim në komunitetin serb në Kosovë

Intervali i besimit: +/- 5% për dukuri me një incidencë të pritur prej 50%

Deklaratë për mosmbajtje përgjegjësie:

Duke pasur parasysh faktin se nuk ka statistika zyrtare mbi strukturën demografike të popullsisë së synuar, pra të popullsisë serbe në Kosovë, vetëm kushtimisht mund të flasim për përfaqësim të mostrës së këtij hulumtimi.

Metodologjia dhe modeli i hulumtimit sasior:

Anketimi ballë për ballë në terren u krye në periudhën nga 1 deri më 20 tetor 2020. Gjithsej 582 qytetarë serb u anketuan në të gjithë Kosovën. 50.5% e të anketuarve janë anketuar në jug të lumit Ibër, ndërsa 49.5% e të anketuarve janë anketuar në veri të lumit Ibër. Pyetësori përbëhej nga 65 pyetje dhe përfshinte gjithsej 8 fusha. Mostra ishte e qëllimshme, me kuota, dhe kriteri për përcaktimin e kuotave ishte madhësia e komunës. Intervali i besimit është +/- 5. Në mostër, kishte gjithsej 54.7% meshkuj dhe 45.3% femra. Moshë mesatare e të anketuarve është 44 vjeç. Me arsim

fillor ishin 14.4% të të anketuarve, 62.1% me arsim të mesme dhe 23.5% me arsimin të lartë, pra fakultet. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 25.9% janë të punësuar në sektorin publik, 22.3% në sektorin privat, 35.2% janë të papunë, ndërsa 16.6% janë në pension. Është e rëndësishme të theksohet se duke pasur parasysh faktin se nuk ka statistika zyrtare mbi strukturën demografike të popullsisë së synuar, pra të popullsisë serbe në Kosovë, vetëm kushtimisht mund të flasim për përfaqësim të mostrës

Hulumtimi cilësor:

Analiza kritike: Përveç metodës sasiore, tri metoda cilësore luajtën një rol qendror në hulumtim - analiza kritike, grupet e fokusit me qytetarë dhe intervista me përfaqësues të partive politike dhe vendimmarrësit. Për të përcaktuar bazën teorike të hulumtimit dhe temën që u mbulua, në fushën e partive politike, u përpunua literatura përkatëse nga fusha e partive politike, sistemet e partive, konkurrenca partiake dhe zgjedhjet. Për më tepër, analiza kritike u plotësuar nga tekste nga fusha e Ballkanologjisë dhe historia e zgjidhjes së çështjes së Kosovës, si dhe tekste nga media, të cilat shërbyen për të përshkruar kronologjinë e ngjarjeve.

Intervistat Në këtë studim, analiza kritike u plotësua me intervista (*elite interviews*) me përfaqësues të pesë partive politike serbe të Kosovës, dhe grupe të fokusit me qytetarë, në mënyrë që të përcaktohet perceptimi dhe besimi i qytetarëve në lidhje me partitë politike. Intervistat u zhvilluan me përfaqësuesit e: Partisë Demokratike Progresive (PDS), Partisë së serbëve të Kosovës (PKS), Drejtësisë Popullore (NP), Partisë Demokratike Serbe të Kosovës Metohisë dhe Partisë së re të Kosovës (NPK), që iu përgjigjën ftesës për intervista.

Grupet e fokusit Në kuadër të hulumtimit, u realizuan 4 grupe të fokusit me 28 qytetarë nga veriu dhe jugu i Kosovës, të segmentuar sipas gjinisë dhe moshës. Grupet e fokusit ofruan një

pasqyrë më të thellë në perceptimet e qytetarëve për partitë politike dhe arritëm të një kuptim se si qytetarët e shohin skenën partiake të serbeve të Kosovës, organizimin e partive dhe ndikimin e partive në jetën e përditshme.

Metodologjia dhe dizajni i kërkimit cilësor:

GRUPET E FOKUSIT

Periudha:

Nga 01 deri më 18.09.2020

Instrumenti i hulumtimit:

Një udhëzues bisede me 6 pyetje

Numri i grupeve të fokusit:

4 grupe të fokusit

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve:

28 pjesëmarrës (nga 7 pjesëmarrës në secilin fokus grup)

Kriteret për përzgjedhjen e pjesëmarrësve:

Gjinia, moshë

INTERVISTAT

Periudha:

Nga 10 deri më 20.10.2020

Instrumenti i hulumtimit:

Udhëzues për intervistë me 11 pyetje

Numri i përgjithshëm i të intervistuarve:

5 të intervistuar

Kriteret për zgjedhjen e bashkëbiseduesve:

Përkatësia partiake

3. Partitë politike serbe të Kosovës, nga pluralizmi te monizmi

Hyrje

Partitë politike dhe politika e serbëve të Kosovës që nga viti 1999 dhe ardhja e forcave ndërkombëtare në Kosovë, posaçërisht menjëherë para dhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, janë zhvilluar në një mjedis kompleks socio-politik. Serbët e Kosovës dhe përfaqësuesit e tyre politikë janë përballur me një numër sfidash, që bien ndesh me dëshirat dhe aspiratat e tyre për të mos pranuar integrimin në sistemin politik dhe ligjor të Kosovës dhe realitetin politik që i ka detyruar ta bëjnë këtë. Në korpusin politik serb, historikisht, çështja e Kosovës kërkonte njëtrajtshmëri politike dhe qarqet qeverisëse në Beograd kërkuan unitet dhe harmoni. Të nxënë midis një çekani dhe kudhre, varësisë politiko-ekonomike dhe besnikërisë së kërkuar nga Beogradi, si dhe presionit për të marrë pjesë në jetën politike të Kosovës, serbët e Kosovës, përkundër përpjekjeve të shumta, ishin përgjithësisht të kufizuar në artikullimin e politikave të tyre. Të ballafaquar me një deficit demografik, emigracion, mungesë të potencialit njerëzor, si dhe humbje të elitës intelektuale dhe akademike, ata ishin kryesisht (përveç në momente të rralla) të dënur të jenë një instrument politik, por jo një aktor i rëndësishëm politik. Në një mjedis të tillë, zhvillimi i partive politike dhe sistemi i partive në mesin e serbëve të Kosovës ishte kaotik, ad hoc dhe i kushtëzuar nga prirjet më të gjera politike dhe shoqërore, si në drejtim të zgjidhjes së statusit të Kosovës ashtu edhe në ndryshimet politike në

Beograd. Partitë politike serbe të Kosovës, deri në vitin 2014 (veçanërisht në veri të Kosovës, disi më pak në jug), ishin kryesisht degë të partive politike të vendosura në Serbi. Fuqia politike e udhëheqësve serbë të Kosovës varej nga forca e patronëve të tyre politikë në Beograd, dhe me ndryshimin e qeverisë në Serbi, hierarkia politike gjithashtu ndryshoi. Në të njëjtën kohë, bisedimet për statusin e Kosovës dhe normalizimin e marrëdhënieve çuan Beogradin të insistonte në besnikërinë politike të serbëve të Kosovës, nga bashkëpunimi dhe pranimi i integritetit i të cilave varej pozicioni ndërkombëtar i Beogradit si një partner i besueshëm. Natyra e rendit politik, mungesa e institucioneve të qëndrueshme dhe deficitit demokratik në Ballkan, por kryesisht në Serbi dhe Kosovë, gjithashtu kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e partive politike në mesin e serbëve të Kosovës. Në një rajon të dominuar nga një nivel i ulët respekti për të drejtat e njeriut, ku traditat politike demokratike janë në një nivel jo të kënaqshëm, ishte e vështirë të vendoseshin sisteme funksionale politike, me rregulla të qarta të lojës dhe partitë politike si lidhje midis votuesve dhe institucioneve politike. Në këtë kuptim, një kufizim i rëndësishëm i organizimit politik të serbëve të Kosovës është perceptimi i mungesës së lirisë dhe presioneve të pësuar nga qytetarët nga përfaqësuesit politikë dhe institucionalë. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të përcaktohen arsyet e mungesës së pluralizmit politik në mesin e serbëve të Kosovës.

4. Ndikimet në zhvillimin e sistemit partiak serb të Kosovës

Sipas Sllavisha Orloviq, sistemi partiak zakonisht kushtëzohet nga mjedisi shoqëror dhe korniza institucionale në të cilën veprojnë partitë. Sipas tij, këto ndikime janë të shumta, si në vetë natyrën e konkurrencës, ashtu edhe në aftësinë e palëve për të arritur qëllimet e dëshiruara. "Numri i partive në një vend po rritet me shumëllojshmëri (*diversity*) të strukturave shoqërore dhe me një strukturë (sistem) zgjedhore proporcionale, por këto efekte janë gjithashtu interaktive."¹ Në atë kuptim, dinamiken dhe trendet e zhvillimit të sistemit partiak të serbëve të Kosovës, mund t'i ndjekim përmes 6 niveleve, dhe ato janë: dimensionin i përkohësisë (kohorë); dimensionin gjeografik; dimensionin ideologjiko-politik; partokracia dhe klientelizmi; rolin dhe ndikimin e Beogradit tek serbët e Kosovës; sistemin partiak dhe zgjedhor.

Dimensioni i përkohësisë përkatësisht kohorë i ndikimit në zhvillimin e partive politike serbe në Kosovë

Zhvillimi i partive politike serbe të Kosovës mund të ndahet në dy periudha kohore. E para është

nga viti 2000 deri në vitin 2013, dhe e dyta është nga viti 2013, pra nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit dhe fillimi i integritit të pothuajse të gjithë spektrit kosovaro-serb në kornizën politike dhe ligjore të Kosovës. Periudha e parë nga viti 2000 deri në vitin 2013 u karakterizua kryesisht nga refuzimi dhe vështirësitë e përfaqësuesve politikë serbë të Kosovës dhe partive politike serbe për t'u integruar në institucionet e Kosovës. Kjo vlen për periudhën para por edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Përkundër pjesëmarrjes sporadike të serbëve në zgjedhjet e Kosovës dhe në institucionet qendrore të Kosovës, kur morën pjesë një numër partish dhe listash elektorale, autoritetet e Beogradit përgjithësisht nuk i mbështetën zgjedhjet, dhe vetë përfaqësuesit politikë serbë, veçanërisht ata në veri nuk shprehën një dëshirë të tillë. Përfundimi ishte në 2001, kur, me mbështetjen e Beogradit, koalicioni i Kthimit fitoi rreth 80,000 vota dhe kishte 22 vende, dhe në qeveri drejtoi Ministrinë e Bujqësisë. Sidoqoftë, përballur me përçarje reciproke, mungesë kohezioni dhe sinjale të paqarta nga autoritetet e Beogradit, "Kthimi" nuk kishte sukses në Kuvend dhe në Qeverinë e Kosovës. Sipas njërit prej udhëheqësve të koalicionit, ata ishin injoruar në Kuvendin e Kosovës dhe propozimet dhe ndryshimet e tyre refuzoheshin vazhdimisht, duke rezultuar në braktisje të shpeshtë të sean-

¹ Orlović, S (2001), Partijski sistem Srbije, faqe 11, në Partije i izbori u Srbiji – 20 godina, Čigoja štampa.

cave dhe institucioneve.² Trazirat e marsit 2004 i dhanë fund pjesëmarrjes masive të partive politike serbe në atë periudhë. Periudha deri në 2013 u shënuar gjithashtu nga dështimi i bashkësisë ndërkombëtare dhe elitave politike në Prishtinë për të bindur serbët e Kosovës, veçanërisht ata nga veriu, për të marrë pjesë në institucionet e Kosovës. Zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës në 2004 dhe 2007, si dhe zgjedhjet lokale për kuvendet komunale, u bojkotuan kryesisht nga përfaqësuesit politikë serbë. Si rezultat i bashkëjetesës dhe i përçarjes politike midis Boris Tadiqit dhe Vojislav Koshtunicës, serbët e Kosovës pranorin sinjale të paqarta dhe ata që zotoheshin për bojkotin e zgjedhjeve dhe institucioneve të Kosovës në kushte të tilla zakonisht dolën si fitues politik. Në periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2013, politika serbe e Kosovës në veri të Kosovës, kryesisht vazhdoi të zhvillohej përmes institucioneve serbe që konsideroheshin paralele në Prishtinë. Politikisht, serbët morën pjesë në jetën politike përmes degëve të partive politike në Kosovë, dhe skena politike ishte kryesisht pasqyrë e skenës politike serbe, ku partitë konservatore si SRS dhe DSS në përgjithësi fitonin shumicën e votave. Sidoqoftë, pushteti politik ishte shpërndarë në atë periudhë dhe kishte disa pole të pushtetit politik, në varësi të ndryshimeve politike që ndodhën në Beograd. Përrjashtim në atë periudhë ishte krijimi i Partisë së Pavarur Liberale (SLS) në 2006, e cila zotohej për pjesëmarrje në proceset politike të Kosovës. Përveç pjesëmarrjes në nivelin qendror në 2007, kur fitoi 3 vende, por me legjitimitet kontrovers, pasi vetëm 2.500 serbë votuan për listat serbe, SLS u bë partia kryesore serbe politike që nga zgjedhjet lokale të 2009, në të cilat garoi pavarësisht nga kundërshtimi i Beogradi. Atëherë fitoi pushtetin në Graçanicë, Klllokot, Ranillug dhe Shtërpcë dhe rrumbullakosi fuqinë e saj pas zgjedhjeve qendrore të 2010, kur fitoi një numër të konsiderueshëm të votave serbe në jug të lumit Ibër dhe kishte një pozicion të rëndësishëm në qeverinë e Kosovës.

² Intervistë me një nga përfaqësuesit e Koalicionit "Kthimi", 15 shtator 2020.

Marrëveshja e Brukselit nga prilli 2013 ndryshoi plotësisht dinamikën politike midis serbëve të Kosovës, sepse për herë të parë që nga viti 2001, ajo mundësoi pjesëmarrjen e pothuajse të gjithë spektrit politik serb në Kosovë. Me thyerjen e rezistencës së përfaqësuesve politikë shumëvjeçarë serbë nga veriu i Kosovës, të cilët kundërshtuan integrimin, Beogradi, për zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit, themeloi Iniciativën Qytetare Lista Serbe - catch all - një subjekt politik, i cili paraprakisht në vitin 2017 u regjistrua si parti. Përmes dy cikleve të njëpasnjëshme të zgjedhjeve lokale, në 2013 dhe 2017, si dhe tre raundeve të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, në 2014, 2017 dhe 2019, Lista Serbe konsolidoi fuqinë e saj dhe kështu bëri ndryshime tektonike në skenën partiake kosovaro-serbe. Partitë e tjera ose anëtarët e tyre ose janë bashkuar në Listën Serbe, ose janë marginalizuar përmes një serie presionesh dhe humbesh elektorale. Lista Serbe aktualisht ka kontroll absolut mbi të gjitha 10 komunat me shumicë Serbe dhe 10 vende të rezervuara për komunitetin Serb në Kosovë, dhe kështu një vend të garantuar në qeverinë e Kosovës.

Dimensioni gjeografik i zhvillimit të partive politike serbe në Kosovë

Serbët e Kosovës janë të ndarë gjeografikisht, midis zonës gjeografike relativisht kohezive të katër komunave kryesisht serbe në veri, dhe zonave gjeografikisht të shpërndara në jug të lumit Ibër. Shumica e serbëve jetojnë në Kosovën qendrore në zonën e Graçanicës, në Anamoravë, rreth Shtërpcës dhe pjesërisht në perëndim në rrafshin e Dukagjinit. Numri i saktë i serbëve që jetojnë në Kosovë nuk dihet, duke pasur parasysh se serbët kryesisht bojkotuan regjistrimin e popullsinë në vitin 2011. Kjo ndarje gjeografike në planin afatgjatë ka krijuar pasoja të ndryshme politike dhe ekonomike. Përderisa serbët në jug të lumit Ibër më parë ishin të detyruar të integroheshin në sistemin politik dhe ligjor të Kosovës dhe duhej të ishin shumë më fleksibël në bashkëpunimin me institucionet e Kosovës, serbët në veri të Kosovës i rezistuan integ-

rimin deri në vitin 2013. Ndarja fillestare gjeografike e përfaqësuesve politikë serbë filloi shumë herët, që në fillim të viteve 2000, kur Këshilli Kombëtar Serb (KKS) i atëhershëm i unifikuar u nda dhe kur një pjesë e përfaqësuesve politikë themeluan KKS-në e veriut të Kosovës. Ky hendek politik midis serbëve në veri dhe në jug u theksua veçanërisht pas vitit 2008 dhe shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kur përfaqësuesit serbë në komunat jugore morën pjesë në një numër të respektueshëm në zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës 2010, dhe Partia e Pavarur Liberale (SLS) dhe Lista e Bashkuar Serbe (JSL) ishin subjekte kryesore politike serbe. Me mbështetjen financiare dhe logjistike të Beogradit, që mundësoi mirëmbajtjen e institucioneve serbe në veri të Kosovës dhe sigurinë e zonës së thellë për shkak të vendndodhjes së saj gjeografike, përfaqësuesit e partive politike në veri të Kosovës kanë qenë të vendosur në kërkesat e tyre për t'u integruar. Vetëm Marrëveshja e Brukselit në vitin 2013, për herë të parë që nga viti 2001, mundësoi krijimin e partive koherente dhe kohezive politike serbe që veprojnë në të gjithë territorin e Kosovës ku jetojnë serbët, me Listën Serbe (SL) udhëheqëse, që gëzon mbështetjen e pandarë të Beogradit.

Roli i Beogradit dhe ndikimi i tij në zhvillimin e partive politike në Kosovë

Historikisht Beogradi ka luajtur një rol kryesor në funksionimin e partive politike dhe përfaqësuesve politikë të serbëve në Kosovë. Politikanët serbë në Kosovë funksionojnë nën vëzhgimin e institucioneve serbe dhe figurat kryesore politike u promovuan kryesisht nga autoritetet e Beogradit. Në këtë drejtim, situata politike dhe shoqërore në Beograd reflektohet në situatën politike mes serbëve të Kosovës. Ekzistenca ose jo-ekzistenca e pluralizmit në Beograd transferohet edhe te serbët e Kosovës, kështu që në periudhën kur sistemi politik dhe partiak i Serbisë ishte jashtëzakonisht i pluralizuar, nga viti 2000 në 2014, kishim një dozë të caktuar të pluralizmit në mesin e serbëve të Kosovës. Në një situatë të pluralizmit politik, zërat e mosmarrëveshjes me autoritetet në Beograd

mund të dëgjoheshin midis serbëve të Kosovës, gjë që ishte veçanërisht e dukshme nga viti 2008 deri në 2013, kur autoritetet lokale në veri të Kosovës në komuna të caktuara ishin kundërshtarë të ashpër të autoriteteve republikane. Paradoksalisht, që nga Marrëveshja e Brukselit në vitin 2013 dhe fillimi i integritimit të serbëve në sistemin ligjor dhe politik të Kosovës dhe shkatërimi i rezistencës së ish përfaqësuesve politikë nga veriu, formimi i Iniciativës Qytetare Lista Serbe (SL), votat e mospajtitimit gjithnjë e më rrallë lejoheshin dhe përfaqësuesit e tyre dhe votuesit iu nënshtruan një presioni të ashpër, duke rezultuar në kooptim të tyre, marginalizim ose tërheqje nga politika. Përfaqësuesit e Beogradit, dhe mbi të gjitha Zyra për Kosovë, morën pjesë në fushatën e Listës Serbe dhe agjituan hapur dhe u bënë thirrje qytetarëve të votojnë për përfaqësuesit e kësaj partie, si në zgjedhjet lokale dhe ato qendrore.

Sidoqoftë, roli politik i Beogradit ndaj serbëve të Kosovës nuk mund të thjeshtohet dhe nuk është një fenomen i thjeshtë. Duke pasur parasysh rolin historik, demografik dhe varësinë ekonomike-politike dhe të sigurisë, serbët e Kosovës marrin siguri ekzistenciale nga marrëdhënia e tyre me Beogradin të cilin e shohin si mbrojtësin e tyre. Serbët në Kosovë janë një komunitet relativisht i vogël, veçanërisht i shkatërruar pas luftës, por i cili vuan rëndë nga fenomeni i rrjedhjes së trurit (brain drain).³ Në të njëjtën kohë, serbët e Kosovës janë të varur ekonomikisht nga Beogradi dhe varësia ekonomike sjell me vete varësinë politike. Serbia investon më së shumti në komunitetet serbe në Kosovë, në mënyrë të pakrahasueshme më shumë sesa Qeveria e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare. Vetëm për funksionimin e Zyrës për Kosovë, 67 milion euro janë ndarë nga buxheti i Serbisë⁴. Sidoqoftë, fondet që Beogradi u shpërndan serbëve të Kosovës janë dukshëm më të larta, sepse fondet që i përkasin Zyrës për Kosovë nuk përfshijnë fonde që Beogradi dërgon

3 OJQ AKTIV (2019), Analiza e Trendit, thotë se 55.3% e serbëve të Kosovës synojnë të largohen nga Kosova në 5 vitet e ardhshme, nga të cilat 2/3 me arsim të lartë.

4 RFE: Serbia planifikon shpenzime edhe më të larta buxhetore për Kosovën, e qasshme në: <https://www.slobodnaevropa.org/a/srbija-kosovo-budzet/30258118.html>

përmes ministrive të linjës për funksionimin e institucioneve, arsimin, shëndetësisë dhe administratës publike republikane serbe në Kosovë. Këtu duhet shtuar mbështetjen për ndërmarrjet, subvencionet, dhe investimet e rregullta, të cilat vitet e fundit mund të maten në dhjetëra miliona euro.⁵ Nëse i kemi parasysh të gjitha këto, alokimet vjetore të Beogradit për Kosovën tejkalojnë shifrën e disa qindra milion eurove. Prandaj, nëse e kuptojmë varësinë e sigurisë, ekonomike dhe politike, atëherë nuk është për t'u habitur që serbët e Kosovës, pa u menduar shumë, ndjekin mesazhet e Beogradit me presion shtesë dhe lidhin besnikërinë e tyre politike me ata përfaqësues politikë që Beogradi mbështet. Gjithashtu, një nga shtyllat në të cilën mbështetet politika e jashtme e Serbisë është perceptimi i bashkësisë ndërkombëtare se Beogradi është bashkëpunues në çështjen e Kosovës dhe se është i përkushtuar për dialog mbi normalizimin e marrëdhënieve. Për Beogradin ishte e rëndësishme të kontrollonte serbët e Kosovës dhe përfaqësuesit e tyre politikë në mënyrë që të siguronin zbatimin e marrëveshjeve të rena dakord, por gjithashtu të diktonte dinamikën e negociatave dhe integrimin e serbëve në shoqërinë e Kosovës. Kontrolli i përfaqësuesve politikë serbë është i rëndësishëm për Beogradin për shkak të mundësisë së kontrollit të funksionimit të institucioneve në komunat me shumicë serbe, por gjithashtu edhe ruajtjes së ndikimit të tij në procesin e formimit të qeverisë së Kosovës.

Dimensioni ideologjiko-politik i zhvillimit të partive politike serbe në Kosovë

Shumica e partive politike serbe në Kosovë nuk janë të profilizuara mjaftueshëm nga ana ideologjike, por përfaqësojnë një përzierje të drejtimeve të shumta ideologjike. Bazuar në analizën e programeve shumë të përgjithshme dhe pikëpamjeve të deklaruara publikisht, nuk mund të konkludohet qartë se si partitë politike

serbe mund të pozicionohen përgjatë gjithë vijës ideologjike "majtas-djathta". Kjo është veçanërisht e vërtetë për vijën ekonomike-sociale të ndarjes, sepse partitë nuk ndahen në ato që janë socio-ekonomike "të majta" ose socio-ekonomike "të djathta". Gjithashtu është e diskutueshme nëse ekziston një ndarje në "nacionalistë" ose "kozmpolit", sepse një sistem politik dhe partiak i bazuar në konsocializëm dhe duke siguruar të drejtën e pakicave për të marrë pjesë në institucione domosdoshmërisht i çon partitë jo-shumicë në "nacionalizmin" deklarativ sesa "kozmpolitizmi". Ajo që mund të vërehet si një ndarje ideologjike-politike brenda komunitetit serb është ndarja në ato parti politike që mbështesin një lloj bashkëpunimi dhe integrimi, qoftë nga pikëpamja ideologjike apo pragmatike, dhe ato që e kundërshtojnë atë integrim. Nga njëra anë, përfaqësuesit e qartë do të ishin përfaqësuesit e Partisë së Pavarur Liberale (SLS) ose Partisë Progresive Demokratike (PDS) që mbrojnë integrimin dhe pjesëmarrjen në institucione, dhe nga ana tjetër ish-përfaqësuesit e KKS të veriut të Kosovës, ose përfaqësuesit e sotëm të Lëvizjes «Atdheu» të cilët i rezistojnë çdo integrimi. Ai lloj konflikti ideologjik ekzistonte gjithashtu midis përfaqësuesve politikë të KKS, si rezultat i së cilës ai u nda. Lloji i dytë i ndarjes është ai «demokratik» dhe «jodemokratik», i cili është gjithnjë e më i dukshëm dhe është pasojë e mungesës së pluralizmit politik brenda komunitetit serb në Kosovë. Ajo që mund të thuhet me siguri është se partitë politike serbe në pushtet, të cilat kanë mbështetjen e Beogradit, historikisht janë udhëhequr nga ideologjia e patriotizmit zyrtar kombëtar. Me qëllim të shpalljes së unitetit kombëtar për hir të «mbrojtjes së Kosovës», shfaqet nevoja për monizëm partiak politik dhe shënjimim e të tjerëve si tradhtarë ose bashkëpunëtorë të «shqiptarëve».

5 N1: Vuçiq: Rreth 50 milion euro investime shtesë në Kosovë, e qasshme: <http://rs.n1info.com/Vesti/a431890/Vucic-o-investicijama-na-Kosovu.html>

Partokracia dhe marrëdhënia klienteliste midis qytetarëve dhe partive politike

Jeta politike e serbëve të Kosovës shënohet nga partokracia dhe një marrëdhënie klienteliste midis qytetarëve dhe partive politike në pushtet. Sipas Orloviq, "partokracia përfaqëson sundimin e partive, domethënë gjendjen e sistemit politik në të cilin partitë kanë epërsi mbi organet e shtetit kushtetues".⁶ Në komunitetet serbe në Kosovë, partokracia pasqyrohet më së miri në faktin se partitë politike në pushtet dhe përfaqësuesit e tyre kanë ruajtur kontrollin absolut mbi punësimin në institucione dhe ndërmarrjet publike, si dhe emërimin e menaxhmentit në organizatat kryesore publike. Në atë mënyrë, krijohet një marrëdhënie klienteliste midis partive dhe qytetarëve, ku qytetarët mendojnë se janë nën presion për të votuar për partitë në pushtet për shkak të frikës së humbjes së punës, ose pamundësisë së punësimit në të ardhmen. Ky qëndrim konfirmohet nga fakti se rreth 90% e të anketuarve besojnë se njerëzit kryesisht bashkohen me partitë politike për të gjetur një punë të mirë. Nuk ka një identifikim mjaft të fortë partiak mes serbëve të Kosovës. Kjo dëshmohet nga fakti se shpesh ka një luhajtje në anëtarësimin e partisë, ose atë që në popull quhet "fluturimi" nga partia në parti. Në shumicën e rasteve, ky "fluturim" bëhet nga partitë e opozitës tek partitë në pushtet. Duke pasur parasysh që votuesit mund të ndjekin interesat e tyre materiale kryesisht jo përmes të mirës publike, dhe se ata sigurojnë të mira përmes klientelizmit partiak, partitë politike në mesin e serbëve të Kosovës mund të konsiderohen kryesisht parti klienteliste. Sipas Vlladimir Goati, partitë klienteliste fitojnë anëtarësim duke i siguruar atij përfitime selektive (jo kolektive) në formën e "vendeve të patronazhit, trajtimit preferencial në shpërndarjen e subvencioneve sociale (fondeve, etj.) dhe kontratave qeveritare". Përveç kësaj, kjo duhet të përfshijë stimuj të statusit, përkatësisht përparim të përsheptuar të karrierës profesionale dhe/ose ngjitje të shpejtë në "piramidën" politike.⁷

6 Orlović, S (2001), Partijski sistem Srbije, faqe 58, në Partije i izbori u Srbiji – 20 godina, Čigoja štampa.

7 Goati, V (2007), Političke partije i partijski sistemi, faqe 138, në Političke partije i partijski sistemi, CEMI

Sistemi partiak dhe zgjedhor

Gjovani Sartori klasifikon sistemet partiake në sisteme të fragmentimit të ulët, me më pak se pesë parti dhe sisteme të fragmentimit të lartë, me më shumë se pesë parti. Bazuar në këtë, ai klasifikon sistemet partiake në: një partiake; sisteme me një parti hegjemoniste; sisteme me një parti mbizotëruese; sisteme dypartiake; sisteme me pluralizëm të kufizuar; sisteme me pluralizëm ekstrem, dhe sisteme të atomizuara⁸. Bazuar në të gjitha sa më sipër, deri në vitin 2013, ekzistonte një lloj pluralizmi i kufizuar midis partive politike serbe të Kosovës, ku ekzistonte mundësia që partitë të luftonin në zgjedhje relativisht të lira për votuesit, dhe zakonisht kishte më shumë përfaqësues të partive në qeverinë qendrore dhe qeveritë lokale, kështu që shpesh kërkohej formimi i koalicioneve në nivelin lokal. Që nga zgjedhjet lokale në 2013 dhe themelimi i Iniciativës Qytetare Lista Serbe, e cila mori mbështetjen absolute të autoriteteve në Beograd, ka pasur një ndryshim në sistemin partiak. Sot, duke pasur parasysh që Lista Serbe ka një shumicë absolute në të gjitha 10 komunat me shumicë Serbe, me përfaqësues të opozitës vetëm në gjurmë, dhe se fitoi të 10 vendet e garantuara që i përkasin komunitetit Serb në Kuvendin e Kosovës, mund të themi se kemi një sistem me parti hegjemonike, ose një sistem në të cilin lejohej partitë ose lëvizjet e opozitës, por për shkak të kufizimeve të shumta, nga presionet, mungesa e disponueshmërisë së mediave dhe fondeve publike, nuk janë në gjendje të konkurrojnë në baza të barabarta me ato parti dominuese.

Përveç kërkesës për "unitet serb", sistemi zgjedhor në nivelin qendror, si dhe rregullat kushtetuese, të cilat kërkojnë që përfaqësuesit në qeverinë e komuniteteve jo-shumicë duhet të mbështeten nga përfaqësuesit e zgjedhur të atij komuniteti në Kuvend, luajti një rol të madh në krijimin e një sistemi të tillë partiak.⁹ Duke pasur parasysh se serbët e

8 Sartori, Gj. (2002), Stranke i stranački sistemi, faqe 115, Filip Višnjić

9 Neni 96, paragrafi 5 i Kushtetutës së Kosovës thotë se zgjedhja e ministrave dhe zëvendësministrave serb dhe të komuniteteve jo shumicë do të vendoset pas konsultimit me partitë, me koalicionet ose grupet që përfaqësojnë

Kosovës kanë 10 vende të garantuara në Kuvend dhe të paktën një vend të garantuar në Qeverinë e Kosovës, partitë politike serbe të Kosovës kanë një ndikim të madh në formimin dhe funksionimin e institucioneve. Për më tepër, ishte e rëndësishme për përfaqësuesit e Beogradit dhe Listës Serbe të kontrollonin të 10 vendet e garantuara. Deputetët në Kosovë zgjidhen nga një sistem zgjedhor proporcional përmes listave të hapura të partive, dhe vendet në kuvend ndahen përmes sistemit të koeficientit më të lartë, përkatësisht metodës Sainte-Laguë.¹⁰ Përderisa kjo metodë kontribuon në raportin optimal midis numrit të votave të fituara dhe numrit të vendeve në listën e kandidatëve, kur aplikohet në 10 vendet e garantuara për serbët e Kosovës, kjo mund të rezultojë, që mjaftojnë vetëm 2-3 mijë vota për të fituar mandatin e dhjetë të fundit. Për atë arsye, presioni mbi partinë që ka mbështetjen e Beogradit për të fituar sa më shumë vota të jetë e mundur, dhe për të parandaluar që ndonjë parti tjetër e serbëve të Kosovës të hyjë në Kuvendin e Kosovës, është gjithnjë e më e madhe.¹¹

Sipas raportit të Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian (EU EOM), zgjedhjet në mjediset serbe në Kosovë në 2017 dhe 2019 po zhvillohen nën velin e parregullsisë të shumta. Sipas Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të BE-së, zgjedhjet u shënuan nga mungesa e pluralizmit, ndërsa vetë fushata u ndërpre nga "frikësimi i kandidatëve që nuk janë të Listës Serbe dhe mbështetësve të partive të tjera". Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i BE-së theksoi gjithash-

komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë. Nëse emërohen jashtë anëtarësisë së Kuvendit të Kosovës, këta ministra dhe zëvendësministra kërkojnë miratimin zyrtar të shumicës së anëtarëve të Kuvendit që u përkasin partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur të cilët kanë deklaruar veten si përfaqësues të komunitetit përkatës.

10 Gjatë llogaritjes së pjesëtuesit më të ulët të përbashkët si kriter për shpërndarjen e mandateve midis listave të kandidatëve, numri i votave të fituara nga secila nga listat e kandidatëve ndahet individualisht me numrat e rritur. Në vend të numrit 1 me 1.4, në vend të numrit 2 me 4, në vend të numrit 3 me 7 e kështu me radhë deri në numrin N sa deputetë zgjidhen në njësinë elektorale. Përparësia e metodës së Sainte-Laguë mbi metodën e D'Hondt është se ajo kontribuon në një raport më optimal midis numrit të votave të fituara dhe numrit të mandateve që i përkasin listës së kandidatëve.

11 Në vitin 2014, PDS e Nenad Rashiqi hyri në parlament jashtë Listës Serbe me 5973 vota, në 2017, SLS e Sllobodan Petroviq pati sukses me 3540 vota. Në vitin 2019, për të hyrë në parlament, disa prej partive Serbe, përveç Listës Serbe, kishin nevojë për rreth 3,000 vota. Asnjë parti tjetër nuk arriti të merrte atë numër votash.



Duke pasur parasysh se serbët e Kosovës kanë 10 vende të garantuara në Kuvend dhe të paktën një vend të garantuar në Qeverinë e Kosovës, partitë politike serbe të Kosovës kanë një ndikim të madh në formimin dhe funksionimin e institucioneve. Për më tepër, ishte e rëndësishme për përfaqësuesit e Beogradit dhe Listës Serbe të kontrollonin të 10 vendet e garantuara.

tu se LS ishte mbështetur me gjithë zemër nga qeveria e Beogradit, e cila gjithashtu delegjitimoi partitë e tjera serbe të Kosovës. Partitë e opozitës nuk mund të bënin fushatë efektive, si për shkak të mungesës së fondeve dhe presionit dhe qasjes së pamjaftueshme në media. Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i BE-së ka identifikuar një numër kërcënimesh ndaj kandidatëve dhe votuesve opozitarë që përballen me humbje ose pezullim të vendit të punës. Raporti thekson se liritë themelore të zgjedhjes, fjalës dhe mbledhjes u cenuan nga partia në pushtet, dhe se rivalët e tyre nuk ishin të mbrojtur sa duhet nga institucionet zyrtare.¹²

12 Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i BE-së, Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2019 - Raporti Përfundimtar, i qasshëm në: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/eueomkosovo2019_finalreport_en_withcover.pdf

Fakti që dy ish-kandidatë për kryetar të Mitrovicës së Veriut, Dimitrije Janiqijeviq (SLS) dhe Olliver Ivanoviq nga GI SDP, humbën jetën në rrethana të pashpjegueshme në vitin 2014 dhe 2018, gjithashtu flet për vështirësinë e aktiviteteve të opozitës në komunitetet serbe në Kosovë.

5. Cilët janë akterët e rëndësishëm dhe roli i tyre

Në regjistrin e partive politike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), janë regjistruar vetëm 5 parti politike serbe të Kosovës. Nga këto, vetëm tre parti mund të thuhet se janë aktive në jetën politike, përkatësisht Lista Serbe (SL), Partia e Serbëve të Kosovës (PKS) dhe Partia Demokratike Progresive (PDS).¹³ Deri vonë, Partia e Pavarur Liberale (SLS) ishte gjithashtu aktive, por ata vendosën të pezullonin aktivitetet e tyre pas dështimit në zgjedhjet e 2019 dhe u fshinë nga regjistri i partive politike.¹⁴ Shumica e akterëve politikë serbë të Kosovës, të cilët marrin pjesë në zgjedhje, zgjedhin të marrin pjesë si iniciativa qytetare, dhe pas zgjedhjeve ata përgjithësisht vazhdojnë aktivitetet e tyre si grupe joformale në rast të mos kalimit të regjistrimit të popullsisë dhe mos hyrjes në kuvendet komunale ose në Kuvend të Kosovës. Në zgjedhjet e mëparshme për Kuvendin e Kosovës, në vitin 2019, morën pjesë vetëm katër lista zgjedhore kosovaro-serbe.

Lista Serbe (LS - Srpska Lista), u bë partia politike dominuese serbe pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit në 2013. E themeluar si një iniciativë qytetare me mbështetjen e Beogradit, kontribuoi

në marginalizimin e liderëve të atëhershëm në veri të Kosovës që kundërshtuan integrimin në sistemin politik dhe ligjor të Kosovës, ndërsa i dha fund monopolit të Partisë së Pavarur Liberale (SLS) në jug të Kosovës. LS u regjistrua si parti politike në maj të vitit 2017, pak para zgjedhjeve. Përmes dy raundeve të njëpasnjëshme të zgjedhjeve lokale të vitit 2013 dhe 2017, dhe tre raundeve të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në 2014, 2017 dhe 2019, LS ka konsoliduar plotësisht fuqinë e saj dhe aktualisht ka pushtet absolut në të 10 komunat me shumicë serbe, dhe kontrollojnë të gjitha 10 vende të garantuara në Kuvendin e Kosovës. Në zgjedhjet e fundit, LS fitoi 53,861 vota, që është 94% e të gjitha votave për partitë serbe të Kosovës. Që nga viti 2014, LS ka qenë partia kryesore serbe në Qeverinë e Kosovës dhe kontrollojnë pozitat e disa zëvendësministrave, si dhe pozitën e Drejtorit të Zyrës për Çështje të Komuniteteve. Për sa i përket komunikimit politik, LS këmbëngul në unitetin e serbëve të Kosovës, duke theksuar se është e vetmja parti që ka mbështetjen e Beogradit, ndërsa diskrediton partitë e opozitës me një fushatë mediatike, duke i akuzuar ato si jo besnike ndaj Serbisë.¹⁵

Qeveria këmbëngul në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit, veçanërisht krijimin e Asociacionit të Komunave Serbe (AKS), kthimin e personave të

¹³ KQZ: Regjistri i partive politike, i qasshëm në: https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/KOZ_Regjistri-i-Partive-Politike.pdf

¹⁴ Kosovo-Online: SLS është fshirë nga regjistri i partive politike në Kosovë, e qasshme në: <https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/samostalna-liberalna-stranka-izbrisana-iz-registra-politickih-partija-na-kosovu-10-6>

¹⁵ Intervista me përfaqësues të partive, lëvizjeve dhe nismave qytetare të opozitës, shtator-tetor 2020

zhvendosur, zhvillimin ekonomik dhe sigurinë e popullit serb në Kosovë.

Partia e Pavarur Liberale (SLS) u krijua në vitin 2006, dhe në periudhën 2007 - 2019 ajo kishte përfaqësues të rregullt në Kuvendin e Kosovës, dhe nga viti 2009 deri në 2013 ajo mbajti një monopol si një parti kryesore e serbëve të Kosovës në zonat serbe në jug të lumit Ibër, ku udhëhoqi të 6 komunat serbe dhe kishte numrin më të madh të deputetëve në Kuvendin e Kosovës. Përfaqësuesit e SLS kryesuan gjithashtu disa ministri. Në zgjedhjet e vitit 2019, SLS nuk arriti të kalojë pragun dhe të hyjë në Kuvendin e Kosovës, dhe në qershor 2020, partia pezulloi aktivitetet e saj dhe u fshi nga regjistri i partive politike.

Në fushatën e fundit zgjedhore, Slobodan Petroviq, kryetar shumëvjeçarë i SLS, theksoi disa herë se anëtarët e partisë së tij dhe familjet e tyre ishin të ekspozuar ndaj presionit nga Lista Serbe.¹⁶ SLS gjithashtu është përballur me një humbje të anëtarësisë që nga viti 2013, pasi shumica e ish anëtarëve të saj i janë bashkuar Listës Serbe, duke përfshirë disa kryetarë aktualë të komunave, deputetë dhe ministra. Edhe para zgjedhjeve të vitit 2017 dhe 2019, anëtarët e SLS u larguan nga partia ose u tërhoqën nga kandidimi për shkak të presionit.

Partia Demokratike Progressive (PDS) është një parti politike e formuar në vitin 2013, kur Nenad Rashedi u largua nga SLS. Në atë kohë, Rashedi ishte Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale. Në zgjedhjet e vitit 2014, PDS arriti të fitonte një vend në Kuvendin e Kosovës. Në zgjedhjet e vitit 2017, kjo parti nuk arriti të hynte në parlament, ndërsa në zgjedhjet e vitit 2019, PDS mori pjesë në koalicionin "Liria" me Partinë e Re të Kosovës të Dragisha Miriq, dhe Rada Trajkoviq, nga Lëvizja Evropiane e Serbëve nga Kosova, ishte gjithashtu në listë. Në një intervistë me një përfaqësues të PDS, ai deklaroi se problemi më i madh i partive politike

¹⁶ VoA: Sukob SLS I SLČ Ko zastrašuje birače uoči izbora? <https://www.glasamerike.net/a/sukob-samostalne-liberalne-stranke-i-sprske-liste-ko-zastrašuje-birače-uoči-izbora-/5077530.html>



Shumica e akterëve politikë serbë të Kosovës, të cilët marrin pjesë në zgjedhje, zgjedhin të marrin pjesë si iniciativa qytetare, dhe pas zgjedhjeve ata përgjithësisht vazhdojnë aktivitetet e tyre si grupe joformale në rast të mos kalimit të regjistrimit të popullsisë dhe mos hyrjes në kuvendet komunale ose në Kuvend të Kosovës. Në zgjedhjet e mëparshme për Kuvendin e Kosovës, në vitin 2019, morën pjesë vetëm katër lista zgjedhore kosovaro-serbe.

të opozitës serbe të Kosovës është presioni që ata dhe votuesit e tyre vuajnë.

Partia e Serbëve të Kosovës (PKS) u krijua në maj të vitit 2015, pas një konflikti brenda Listës Serbe, e cila u braktis nga njëri prej themeluesve dhe ish-Ministri i Kthimit, Aleksandar Jabllanoviq. Jabllanoviqit iu bashkuan besnikët, kryesisht nga komuna e Leposaviq, duke përfshirë kryetarin e atëhershëm të Leposaviqit, Dragan Jabllanoviq. PKS dhe Aleksandar Jabllanoviq këmbëngulin të kritikojnë Listën Serbe. Në zgjedhjet lokale në 2017, ata arritën të fitojnë një numër të caktuar vendesh në kuvendin komunal në Leposaviq, por nuk arritën të fitojnë një vend në parlament në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës në 2017 dhe 2019.

Partia e Re e Kosovës (NPK) u formua si pasardhëse e Partisë Demokratike Serbe të Kosovë Metohisë, e cila garoi dy herë në zgjedhjet parlamentare të Kosovës në 2007 dhe 2010. Lideri i NPK Dragisha Miriq ka qenë në institucionet e Kosovës që nga 2005. Ai së pari shërbeu si këshilltar i Ministrisë të Arsimit në Qeverinë e Kosovës nga viti 2005 në 2007, dhe pastaj nga 2007 në 2011 ishte deputet në Kuvendin e Kosovës. Partia ishte në koalicionin parazgjedhor "Liria" (Sloboda) me PDS, në 2019,

por Dragisha Miriq me dy kandidatët e tjerë parlamentarë u larguan nga koalicioni për shkak të mosmarrëveshjeve me Nenad Rashiqin¹⁷

IQ Liria, Demokracia, Drejtësia (GI SDP) u themelua në vitin 2013 nga udhëheqësi shumëvjeçar i Serbëve të Kosovës Olliver Ivanoviq, pak para zgjedhjeve të para lokale në veri të Kosovës. GI SDP ishte rivali kryesor i Listës Serbe, dhe përveç hyrjes në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarët e Mitrovicës së Veriut dhe Zveçanit, ajo gjithashtu fitoi një numër të konsiderueshëm të këshilltarëve komunal në të dy komunat. Pas arrestimit të udhëheqësit të saj, Olliver Ivanoviq, pak para përsëritjes së zgjedhjeve për kryetar të komunës në 2014, Iniciativa qytetare ngadalë filloi të shpërbehej, ku disa këshilltarë u larguar nga radhët e saj dhe iu bashkuan Listës Serbe. Pas tre vjet në paraburgim, Olliver Ivanoviq lirohet për t'u mbrojtur në liri dhe GI SDP mori pjesë në zgjedhjet lokale në tetor 2017 në Mitrovicën e Veriut. GI SDP, si partitë e tjera të opozitës, ishte viktimë e një fushate mediatike dhe presioni, duke çuar në tërheqjen e disa kandidatëve nga listat zgjedhore. Olliver Ivanoviq u vra në janar 2018 në rrethana ende të pasqaruara. Pas vdekjes së tij, GI SDP humbi rëndësinë e saj, ndërsa një pjesë e këshilltarëve komunal në qeveritë lokale vazhduan të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe disa përfaqësues morën pjesë në listën zgjedhore të Listës Serbe në 2019.

Lëvizja Popullore "Atdheu" (Otdžbina) u themelua nga ish-anëtarët e Partisë Demokratike të Serbisë (DSS) të mbledhur rreth Sllavisha Ristiq, ish kryetari i Zubin Potokut dhe Marko Jakshiq, lider i serbëve nga veriu i Kosovës që kundërshtuan integrimin dhe zgjedhjet e Kosovës pas marrëveshjes së Brukselit 2013. Ata janë të njohur si kritikë të ashpër të autoriteteve në Serbi dhe e konsiderojnë pjesëmarrjen në zgjedhjet e Kosovës shkelje të Kushtetutës së Serbisë.



Pas arrestimit të udhëheqësit të saj, Olliver Ivanoviq, pak para përsëritjes së zgjedhjeve për kryetar të komunës në 2014, Iniciativa qytetare ngadalë filloi të shpërbehej, ku disa këshilltarë u larguar nga radhët e saj dhe iu bashkuan Listës Serbe. Pas tre vjet në paraburgim, Olliver Ivanoviq lirohet për t'u mbrojtur në liri dhe GI SDP mori pjesë në zgjedhjet lokale në tetor 2017 në Mitrovicën e Veriut.

IQ Drejtësia Popullore u themelua në vitin 2013 pak para zgjedhjeve lokale në komunën e Leposaviqit dhe fitoi një vend. Në zgjedhjet e vitit 2017, ajo nuk arriti të hynte në kuvendin komunal. IQ Drejtësia Popullore është kritike ndaj Listës Serbe dhe është anëtare e aleancave të opozitës në Serbi.


¹⁷ Večernje Novosti, Miriq nga NPK me dy deputetë u largua nga Sloboda, e qasshme në: <https://www.novosti.rs/vesti/naslovna/politika/aktuelno.289.html:821731-Miric-iz-NPK-sa-voje-poslanika-napustio-Slobodu-zbog-Rasicevog-velicanjatzv-Kosova>

6. Rezultatet e hulumtimit dhe kontekstualizimi i tyre

Pyetja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e të kuptuarit të konceptit "demokracia". Të anketuarit iu ofrua një listë me 9 pikëpamje, dhe detyra e tij është


të vlerësojë në një shkallë prej katër pikash se çfarë nevojitet që një shoqëri të quhet demokratike. Rezultati është paraqitur në Grafikon 1.

Grafiku 1. Ka shumë mënyra të ndryshme se si njerëzit e kuptojnë demokracinë. Cilat mendoni se përshkruajnë më mirë një shoqëri demokratike




Pyetja tjetër përfshiu një set nga tre pikëpamjesh rreth asaj se çka duhet të ishte demokracia, dhe detyra e të anketuarve ishte të vendosnin për pikëpamjen që i përshtatet më mirë qëndrimit të tyre. Rezultati është paraqitur në Grafikon 2.

Grafiku 2. Cila nga pikëpamjet e mëposhtme pasqyron më së afërmi mendimin tuaj?



Çështja e tretë ka të bëjë me vlerësimin e demokracisë në Kosovë. Rezultati është paraqitur në Grafikon 3.

Grafiku 3. - Si do ta vlerësonit demokracinë në Kosovë?



Tri pyetjet e mëparshme u përdorën si instrumente për të përcaktuar se sa qytetarët serbë në Kosovë kanë besim në demokraci si një sistem qeverisjeje. Qytetarët i kanë njohur qartë të gjitha tiparet kryesore të demokracisë si të rëndësishme. Gjithashtu është e qartë se shumica e qytetarëve deklaruan se demokracia është forma më e mirë e qeverisjes, por prapë shqetësues është akti se një nivel i lartë

i qytetarëve janë indiferentë, ndërsa rreth 23.3% besojnë se një regjim autoritar/diktaturë është një formë më e mirë e qeverisjes sesa demokracia.

Pyetja tjetër përfshiu një vlerësim që institucione të caktuara në Kosovë vlerësojnë tek pjesëtarët e popullsisë serbe. Rezultati është paraqitur në Tabelën 1.

Tabela 1. Sa u besoni institucioneve të mëposhtme në Kosovë?


	1	2	3	4	5	NO
Partitë politike serbe	1,1	5,9	4,3	55,6	32,5	0,5
Partitë politike shqiptare	3,9	5,3	6,6	30	53,6	0,6
Autoritetet në Beograd	0,2	6,2	2,6	40,4	45,7	5
Mediat	5,6	9,1	5,2	31,7	47,1	1,3
Vetëqeverisja lokale në Kosovë	0	4,5	3	35,6	41,3	15,7
Sistemi shëndetësor në Kosovë	2,3	8	6,1	36,8	45,4	1,4
Arsimi në Kosovë	1,7	3,5	5,5	29,2	43,8	16,2
Gjyqësori në Kosovë	4,3	4,8	3,5	31,3	55,5	0,6
Qeveria e Kosovës	0,6	11,7	12,9	29,1	33,2	12,5
Kuvendi i Kosovës	4,7	10,7	8,9	30	45,6	0,2
Organizatrat joqeveritare (OJQ)	1,5	11,4	15,9	27	33,3	10,9
Kisha Ortodokse Serbe	6,5	14,1	10	27,4	41,7	0,3
Shtabet Komunale të Krizave në Kosovë përgjegjëse në luftimin e pandemisë COVID-19	4,7	16,6	22,6	23,7	29,9	2,4

1 – nuk e kam fare; 2 – kryesisht jo; 3 – neutral; 4 – kryesisht kam; 5 – kam plotësisht;
NO – pa përgjigje; vlerat janë të shprehura në %.

Është e dukshme se qytetarët kanë besimin më të madh në qeverinë në Beograd me 58% dhe Kishën Ortodokse Serbe me 88.5% të vlerësimeve pozitive. Disi më pak besim kanë në partitë politike serbe, rreth 43%. Është e qartë se qytetarët

kanë shumë pak besim në institucionet e Kosovës, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës, si dhe në vetëqeverisjen lokale dhe sistemin gjyqësor. Nga institucionet, disi më shumë besim qytetarët kanë në sistemin shëndetësor dhe arsimin.

Grafiku 4. Sa pajtoheni me pikëpamjet e mëposhtme



Niveli i lartë i largimit nga bota e politikës në Serbi pasqyrohet më së miri në përgjigjet e të anketuarve në pyetje të tilla si "Njerëzit kryesisht anëtarësohen në parti politike për të gjetur një punë të mirë" (Pajtohem - 76%) dhe "A jam apo jo politikisht aktiv, nuk do të ndikojë në ndryshimet në shoqëri" (Pajtohem - 57.5%). Që rreth 54% e qytetarëve gjithashtu besojnë se nuk duhet të kundërshtohen të fortit dhe të fuqishmit, flet për një dozë të caktuar frike që ekziston në mesin e komunitetit serb në Kosovë.



"Në thelb, unë mendoj se njerëzit në përgjithësi nuk ndjekin politikën edhe aq, veçanërisht të rinjtë, sepse ata e dinë se çfarë të presin, ata e dinë paraprakisht se politikanët nuk duan të zotohen për ta dhe problemet e tyre, për të zgjidhur problemet e tyre në nivel lokal, nga kjo mund të them se ata fare nuk ndjekin e politikën dhe nuk duan të dëgjojnë rreth politikës."¹⁸


Grupet e fokusit që kemi mbajtur si pjesë e hulumtimit konfirmojnë rezultatet e kërkimit mbi tjetërsimin politik. Qëndrimi unanimit në fokus grupet është se "qytetarët po ikin nga politika", dhe se kjo veçanërisht ka të bëjë me të rinjtë. Gjithashtu, shumica e pjesëmarrësve besojnë se qytetarët nuk janë të interesuar në politikë, sepse ata janë "lodhur nga politika". Përshtypja është se politika, partitë politike dhe politikanët në përgjithësi janë "fjalë të thëna", dhe këto aktivitete qytetarët i shmangin.

Sidoqoftë, ka nga ata që nuk pajtohen dhe thonë se problemi nuk është në mosinteresim, por në frikën e përfshirjes në politikë, sepse të rinjtë kanë një shembull të presioneve të njerëzve që u përpoqën të ndryshonin diçka dhe të përfshiheshin në politikë dhe prandaj nuk janë gatshëm rrezikojnë.


Grupi i fundit i pretendimeve i referohej vlerësimit të qëndrimeve ndaj partive politike dhe politikanëve. Detyra e të anketuarve ishte të vlerësonin në një shkallë prej pesë pikash se sa pajtohen me pikëpamjet e paraqitura. Rezultatet janë paraqitur në Grafikon 58 (përmban një grup deklaratash të formuluar pozitivisht) dhe 589 (përmban një grup deklaratash të formuluar negativisht)

¹⁸ Grupi i fokusit me qytetarët serbë, i mbajtur përmes platformës Zoom në shtator 2020.

Grafiku 5. Sa pajtoheni me pikëpamjet e mëposhtme



Grafiku 6. Sa pajtoheni me pikëpamjet e mëposhtme



Instrumenti i fundit me të cilin kemi matur besimin politik të qytetarëve tek politikanët. Përgjigjet e të anketuarve në pyetje vendosin në plan të parë politikanët, hapjen e tyre (pyetja 1), mbajtjen e premtimeve (pyetja 2), kujdesin (pyetja 3), kompetencat (pyetjet 4) qëndrueshmërinë (pyetja 6 dhe 7), sinqeritetin (pyetja 8), hapjen/transparencën (pyetjet 8-10), mbajtjen e premtimeve (pyetjet 11-12) dhe drejtësinë (pyetja 14).

Shikuar nga këndi i pretendimeve individuale, shumica e të anketuarve dyshojnë në qëllimet e politikanëve dhe besojnë se ata marrin parasysh vetëm interesin e tyre personal, deri në 78%, dhe jo interesat e qytetarëve dhe në përgjithësi nuk i kuptojnë nevojat e qytetarëve. Një numër i madh i qytetarëve i konsiderojnë politikanët jo konsistent, madje 70% prej tyre. Qytetarët janë gjithashtu të pakënaqur me sasinë e informacionit që ata marrin nga politikanët serbë në qeveri - 77%.

Këto gjetje u konfirmuan gjithashtu nga fokus grupet, të cilat gjithashtu tregojnë një besim mjaft të ulët të qytetarëve tek politikanët. Ajo që bie në sy është zhgënjimi me mënyrën se si politikanët përfaqësojnë qytetarët dhe fakti që ata nuk i pëmbushin premtimet e tyre mjaftueshëm. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit besojnë se përfaqësuesit politikë dhe partitë politike aktivizohen vetëm gjatë fushatës zgjedhore. Mosbesimi ndaj politikanëve është i përgjithshëm dhe vlen si për politikanët në pushtet ashtu edhe për ata në opozitë.



“Është shumë e thjeshtë. Edhe nëse kemi opozitë, ata nuk po luftojnë për të kontribuar për shtet. Interesi personal vendoset gjithmonë përpara shtetit ose popullit. Dhe ai tjetri që vjen, nuk do të ulet në paletë, do të ulet në kolltuk. Është thjesht diçka që do të përsëritet dhe njerëzit janë viktima. Këtu mbaron çdo histori e mëtejshme. Sa i përket besimit, le të mos gënjejmë, të gjithë erdhën këtu me ndonjë qëllim dhe të gjithë po luftojnë për t'i bërë gjërat më mirë

për veten e tyre nesër. Kështu që ata mendojnë së pari për veten e tyre dhe pastaj për të tjerët. Askush nuk erdhi këtu për të bërë atë që përfaqëson demokracia, për të luftuar në emër të njerëzve. Mendoj se ata nuk e bënë atë ndarje dhe se popullit i është shtypur në vetëdije se ata kontrollojnë situatën, se ata janë këtu për ne dhe jo ne për ta”¹⁹

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit besojnë se politikanët më së shumti preokupohen me interesin personal sesa me publikun, dhe se ata zakonisht nuk kanë kompetencë për të kryer funksionet që mbajnë aktualisht. Kjo gjetje u konfirmua edhe nga përfaqësuesit e partive politike, të cilët theksojnë se vetë fakti që ka një “fluturim” nga partia që humbet pushtetin ndaj partisë në pushtet, flet për faktin se anëtarësimi partiak bëhet për interesa personale. Dhe vet përfaqësuesit e partive që intervistua u përballën me humbjen e anëtarësisë, duke aderuar në partinë në pushtet.




“Për fat të keq, mendoj se interesi personal mbizotëron, kjo është arsyeja pse partitë në pushtet kanë një numër më të madh të anëtarëve dhe kjo ndryshon në mënyrë drastike me kalimin e partisë në opozitë. Ka shumë pak individë midis nesh që ushqejnë bindjet e tyre politike dhe që janë të gatshëm të luftojnë vërtet. Njerëzit bashkohen në parti për përfitime personale, për të gjetur një punë, për të marrë një donacion, ose për të qenë në një pozitë më të lehtë për të përparuar në karrierën e tyre. Përveç kësaj, në të vërtetë nuk kam vërejtur ndonjë qëllim më të madh.”²⁰


19 Grupi i fokusit me qytetarët serbë, i mbajtur përmes platformës Zoom në shtator 2020.


20 Intervistë me përfaqësuesin e PKS, tetor 2020.

Grafiku 7. pyetja Q24 - partitë politike serbe* moshë



Grafiku 8. pyetja Q24 - partitë politike serbe* statusi i punësimit



Grafiku 9. pyetja Q24 - partitë politike serbe* arsimimi

Tre grafikët e mëparshëm tregojnë gjithashtu se sa besojnë qytetarët në partitë politike serbe, pas stratifikimit sipas moshës, statusit të punësimit dhe arsimit. Është e qartë se moshja luan një rol të rëndësishëm në besimin tek partitë politike. 68% e njerëzve mbi 66 vjeç kryesisht u besojnë partive politike serbe. Të rinjtë e moshës 18-29 vjeç kanë më pak besim në partitë politike serbe, vetëm 36%. Sa i përket popullsisë së aftë për punë mbi 30 vjeç, rreth 49% e këtij grupi kanë besim në partitë politike serbe.

Në grupin e statusit të punësimit, më së shumti kanë besim pensionistët 55%, të ndjekur nga punonjësit në sektorin publik me 48%. Të papunët kanë më pak besim, vetëm 37% dhe të punësuarit në sektorin privat, 36%.

Me rritjen e arsimimit formal të popullsisë, bie edhe mbështetja dhe besimi te partitë politike serbe në Kosovë. Më se paku besim, vetëm 40% ka shtresa më e arsimuar, pra, ata me master, magjistratura, doktoratura dhe të diplomuar. Ata me shkollë fillore të përfunduar kanë më shumë besim, 65%.

Intervistat shtesë që kemi realizuar me përfaqësues të partive politike kanë dhënë gjetje më të hollësishme për mungesën e pluralizmit politik, por edhe për presionet me të cilat përballen simpatizantët dhe anëtarët e partive të opozitës. Përfaqësuesit e PDS, PKS, Drejtësisë Popullore dhe Partisë së Re të Kosovës, deklaruan se çdo lloj mosmarëveshje me politikën zyrtare shtypet.



“Thënë thjeshtë, çdo përpjekje për të organizuar ndonjë institucion politik shoqërohet me kërcënime dhe shantazhe të drejtpërdrejta ndaj çdo individi që mund të dëshirojë të merret me politikë.”²¹

Përfaqësuesit e partive politike të opozitës shohin probleme në marrëdhëniet me politikanët serbë, si në Beograd ashtu edhe në Prishtinë. Ndërsa theksojnë presionin dhe mbështetjen e Beogradin për vetëm një parti që gëzon të gjitha përfitimet e mundshme, privilegjet dhe mbështetjen logjistike, dhe në të njëjtën kohë ata e akuzojnë për diskreditim të opozitës.



“Partitë politike të opozitës serbe janë etiketuara si tradhtare, anti-serbe edhe pse nuk kanë bërë dhe nuk do të bënin ndonjë akt tradhtie. Qëndrimi i Beogradit ndaj nesh bazohet në parimin e forcës dhe jo në argumente.”²²

Sa i përket qëndrimit të Prishtinës ndaj partive politike serbe, bashkëbiseduesit deklarojnë se ajo është një marrëdhënie ekskluzivisht për interes dhe se elita qeverisëse në Kosovë nuk ka një qëndrim të sqartë ndaj partive politike serbe, por shikon vetëm se si mund t'i instrumentalizojë ato.

21 Intervistë me përfaqësuesin e PDS, shtator 2020.

22 Intervistë me përfaqësuesin e PKS, tetor 2020.



“Në shumicën dërrmuese të rasteve për partitë politike shqiptare, marrëdhënia, në kuptimin e vërtetë të fjalës, nuk ekziston. Momenti i vetëm që mund të kuptohet si diçka e afërt me të, është dita kur votohet për Qeverinë e Kosovës dhe kur nevojiten votat e deputetëve serbë.”²³

Përfaqësuesi i PKS-së ka një qëndrim të ngjashëm, duke deklaruar se përkundër qëndrimit deklarativ unison në Prishtinë, i cili përpiqet të portretizojë serbët si anëtarë të barabartë të shoqërisë dhe pjesëmarrës në proceset politike, në realitet kjo marrëdhënie barazie nuk arrihet, sepse serbët kryesisht përjashtohen nga proceset e përditshme.

Nga ana tjetër, përfaqësuesi i Drejtësisë Popullore thotë se situata aktuale dhe simulimi i jetës politike dhe mungesa e pluralizmit politik në komunitetin serb i përshtatet të gjithëve, nga Beogradi e deri në Prishtinë dhe bashkësinë ndërkombëtare, për sa kohë që Beogradi dhe përfaqësuesit serbë janë bashkëpunues në procesin e normalizimit.



“Për sa kohë që politika LS i përshtatet Prishtinës, ata asnjëherë dhe në asnjë mënyrë nuk do të mbështesin/ promovojnë zhvillimin e demokracisë këtu (në kuptim të krijimit të kushteve që opozita të dëgjohet dhe shihet). Përkundrazi, ata do të punojnë për të “mbytur” raste të tilla. Fatkeqësisht, nuk është vetëm Prishtina. Dhe të gjitha organizatat ndërkombëtare në Kosovë po punojnë në të njëjtin drejtim, atyre iu duhet LS për të përfunduar punën që kanë filluar.”²⁴

23 Intervistë me përfaqësuesin e PDS, shtator 2020.

24 Intervistë me një përfaqësues të Drejtësisë Popullore, shtator 2020.

Qëndrimet për mungesën e pluralizmit politik ndahen edhe nga qytetarët që morën pjesë në fokus grupe. Ata janë të vetëdijshëm për mungesën e pluralizmit politik, dhe përshtypja e tyre është se ekziston vetëm një parti politike. Ata gjithashtu vënë në dyshim demokracinë e procesit zgjedhor, duke deklaruar se ata vetë kanë dëgjuar ose dëshmuar për një numër parregullsish gjatë zgjedhjeve. Para së gjithash, këta shembuj kanë të bëjnë me votimin e organizuar, frikën e qytetarëve se nëse nuk votojnë për partinë në pushtet do të humbasin vendet e tyre të punës, si dhe pamundësinë për të shprehur opinionin e tyre publik pa hyrë në konflikt me partinë në pushtet.



“Konkretisht, unë mendoj se zgjedhjet nuk janë një proces i lirë, njerëzit që votojnë duhet të votojnë sepse janë të detyruar, kryesisht janë njerëz që punojnë në institucione shtetërore, dhe janë të detyruar të të dalin në zgjedhje dhe të mbledhin një numër të caktuar votash. Konkretisht, mendoj se në atë mënyrë rrezikohet liria e tyre e votës, dhe kur bëhet fjalë për të shprehur pikëpamje publike, sinqerisht mendoj se njerëzit, megjithëse kanë një pozicion të ndryshëm nga regjimi aktual, nuk duhet të shprehin mendimin e tyre sepse në atë mënyrë do të rrezikojnë anën e tyre ekonomike, pra mund të pushohen ose anëtari i familjes së tyre mund të pushohet nga puna, dhe nëse nuk keni mundësi financiare për të jetuar, atëherë jeta juaj është shumë në rrezik.”²⁵

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit gjithashtu deklarojnë se klientelizmi është i kudondodhur, dhe se vendet e punës mund të sigurohen kryesisht përmes lidhjeve politike, dhe përmes një partie politike, e cila lejon partinë në pushtet të kontrollojë një numër të madh të votuesve, të cilët jo domosdoshmërisht kanë një mendim shumë të mirë për politikanët në pushtet.

25 Grupi i fokusit me qytetarët serbë, i mbajtur përmes platformës Zoom në shtator 2020.

Rekomandime

- Në përputhje me rekomandimet e Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të BE-së, të sigurohet respektimi i të drejtave themelore demokratike në procesin zgjedhor, në mënyrë që të mundësohet pjesëmarrja e lirë në të gjitha aspektet e jetës demokratike.
- Mediat në gjuhën serbe duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje partive politike dhe aktiviteteve të tyre publike dhe kështu t'i sjellin partitë politike më pranë qytetarëve.
- Përmes programeve ndërkombëtare mbështetëse të ndihmohet forcimi i brendshëm i partive politike dhe ngritja e kapaciteteve të tyre për një pjesëmarrje të barabartë në jetën politike të partive politike serbe të Kosovës, si dhe t'iu mundësohet të jenë më pranë qytetarëve.
- Të mundësohet zbatimi i ligjeve dhe zgjidhjeve ligjore që parandalojnë klientelizmin dhe partokracinë, dhe kështu të parandalohet krijimi i një marrëdhënie klienteliste midis partive dhe qytetarëve.

Rreth nismës

"Demokracia, hapja dhe perspektiva e komunitetit serb në Kosovë - Open" është një nismë e re e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), e filluar në vitin 2020. Open zbatohet në bashkëpunim me nëntë organizata të shoqërisë civile që veprojnë në komunitetin serb në Kosovë.

Qëllimi i përgjithshëm i nismës së re është të zhvillojë një hapësirë të hapur dhe dinamike për diskutim brenda komunitetit serb, në mes të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera, si dhe institucioneve në Kosovë.

- Nisma do të adresojë në mënyrë specifike analizën dhe vlerësimin e ndikimit të organizatave civile dhe politike mbi demokracinë dhe hapjen e komunitetit serb në Kosovë.
- Do të analizohen dhe vlerësohen demokracia dhe hapja e institucioneve, politikave publike dhe proceset e rëndësishme ndaj komunitetit serb në Kosovë, si dhe shkalla e hapjes së komunitetit serb ndaj tyre.
- Këto analiza do të ndihmojnë për të kuptuar gjendjen aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, përderisa në të njëjtën kohë do shërbejnë si bazë për përfaqësim argumentues ndaj qytetarëve, institucioneve të qeverisë lokale dhe qendrore si dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Organizatave me përvojë dhe të dëshmuara të shoqërisë civile, për të arritur qëllime të përgjithshme dhe specifike do të realizojnë tetë (8) analiza sektoriale.

Fushat që partnerët tanë do të analizojnë në vitin 2020 janë:

Mediat Sa ndikojnë mediat në gjuhën serbe në Kosovë në shkallën e hapjes, qasjes dhe pluralizmit të opinionëve dhe temave? Kjo fushë hulumtohet nga **Qendra Mediale** dhe **Bota bardh e zi**.

Shoqëria civile Si kontribuojnë organizatat e shoqërisë civile në hapjen dhe demokracinë e komunitetit serb dhe shoqërisë në Kosovë në përgjithësi? Me këtë temë merret **Iniciativa e re shoqërore** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

Partitë politike Demokracia dhe pluralizmi i partive politike serbe të Kosovës, hapja e tyre për të marrë pjesë në sistemin politik të Kosovës dhe për të kontribuar në avancimin dhe përmirësimin e politikave publike. Në këto çështje do të fokusohet **Iniciativa e re shoqërore** dhe **Qendra Mediale**

Përgjegjësia e institucioneve Përmes monitorimit të kuptohet më mirë pozita e komunitetit serb në Kosovë dhe se sa të hapur janë institucionet ndaj problemeve të serbëve. Analiza realizohet nga **Bota bardh e zi** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

Siguria Sa ndikon ndjenja e sigurisë në hapjen e komunitetit serb ndaj institucioneve të sigurisë së Kosovës? Në këtë pyetje kërkon përgjigje **Qendra Humane Mitrovica**.

Ekonomia Sa janë të hapura entitetet ekonomike nga komunitetet me shumicë serbe për integrim në ekonominë e Kosovës? Këtë fushë e analizon **Instituti për Zhvillimin Ekonomik Territorial (InTER)**.

Të drejtat e pakicave Si të arrihet një shoqëri më e hapur duke vënë në pah boshllëqet në zbatim të së drejtave të pakicave? Kjo temë shqyrtohet nga **OJQ Aktiv** dhe **Qendra për të Drejtat e Komuniteteve të Pakicave**

Procesi i dialogut dhe normalizimi i marrëdhënieve

Kosovë-Serbi - Deri në çfarë mase përfaqësohet dhe cilat janë qëndrimet e komunitetit serb të Kosovës lidhur me ndikimin dhe të ardhmen e procesit? Kjo analizë realizohet nga **OJQ Aktiv** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

Në fund të ciklit Open 2020 do të publikohet raporti i konsoliduar „**Karakteristikat e shoqërisë së hapur në komunitetin serb të Kosovës**“ duke i vendosë rezultatet dhe përfundimet e analizave bazë të anëtarëve të iniciativës Open në një kontekst më të gjërë socio-politik të Kosovës.

Iniciativa Open është e përkrahur nga KFOS

